

V E N D I M
Nr. 559, datë 23.10.2000

PËR NJË NDRYSHIM TË VENDIMIT NR.213, DATË 28.3.1998, TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE, “PËR RRITJEN E PAGAVE TË FUNKSIONEVE TË LARTA
SHTETËRORE”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 2 dhe 6 të ligjit nr. 8487, datë 13.5.1999, “Për kompetencat për caktimin e pagave të punës”, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministër i Punës dhe i Çështjeve Sociale”, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Në vendimin nr. 213, datë 28.3.1998, të Këshillit të Ministrave, bëhen këto ndryshime:
 - a) Në lidhjen I “Renditja e funksioneve sipas klasifikimit”, në shkronjën “B3” shtohet emërtimi “Drejtor drejtorie në ministri” dhe shfuqizohet ky emërtim në shkronjën “B4”.
 - b) Në lidhjen II-5 “Niveli i pagës për punonjësit e ministrive dhe institucioneve të tjera qendrore”, në numrin rendor 5 shtohet emërtimi “Drejtor drejtorie në ministri” sipas klasifikimit “B3” dhe shfuqizohet ky emërtim në numrin rendor 7.
2. Efektet financiare që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi fillojnë nga data 1.10.2000 dhe do të përballohen nga buxheti i miratuar për vitin 2000, për secilën ministri.
Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Ilir Meta